

E ENJTE DATA 16 SHKURT 2023

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

Zonja drejtuese e seancës,

E gjithë kjo seancë ka filluar në parregullsi të plotë. Ju e keni hapur seancën në orën 10:40, kur seanca duhej të hapej në orën 10:00. I gjithë ky manipulim është bërë në mënyrë që kolegët të mos hynin në sallë dhe për këtë ju mbani përgjegjësi, kështu që nuk mund ta vazhdoni këtë seancë, të cilën ju e keni manipuluar pa filluar. E para. E dyta, nuk është pronare Kryetarja e Kuvendit për pyetjet e deputetëve. Në rast se këtu është konfirmuar (se dakordësi nuk ka pasur, edhe për këtë çështje, sikurse e konfirmoi kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike), jeni sërish në një manipulim të hapur, shumë flagrant dhe asnjë prej jush dhe asnjë lloj mazhorance këtu nuk del dot të imponojë mashtrim për fakt të kryer. Lidhur me këtë çështje ju nuk mund të vazhdoni dot sikur nuk ka ndodhur asgjë, ju mund ta bëni dhe nuk ka asnjë problem, se nuk keni autoritet të veçantë, jeni zëvendësuese apo bedeli i radhës këtu, sepse Kryetarja nuk vjen. Nga kjo pikëpamje, ky standard nuk mund të vendoset kurrën e kurrës.

Sa u takon kërkesave dhe pretendimeve tuaja, se do të mbani standardin e Rregullores, këtu e keni, në qoftë se i dëgjoni, këtu në mikrofon dëgjohen shumë qartë se cilat kanë qenë boritë, sirenat dhe të gjitha gjërat e tjera të aplikuara, ja ku i keni (tregon video), kjo ka qenë mazhoranca dhe në opozitë. Ja ku e keni: me sirena, me bori, me bilbila e me të tjera. Apo ka dy standarde? Kur jemi në mazhorancë dhe na duhet të mbajmë pushtetin, bilbili është faj, kur jemi në opozitë dhe jemi vetë, bilbili është meritë. Po ju kujtoj se në atë kohë nuk përjashtoheshin 18 apo 20 deputetë. Apo, ju keni standardin tuaj? Është e turpshme dhe një fatkeqësi e madhe që të kesh gjëmuar në sallën e parlamentit, siç e keni këtu, të gjithë ju pa përjashtim, sepse ka plot nga këta këtu që janë sot në sallë, pastaj të bëni standardin e shenjtërisë së Rregullores, të cilën e shkatërroni dhe e shkelni vazhdimisht. Unë jam ndërmjet atyre që kanë bërë pyetje dhe të drejtën e pyetjeve nuk ma jepni ju, por ma jep Rregullorja e Kuvendit dhe asnjë njeri nuk mund të marrë vendim mbi pyetjen time, nuk thuhet gjëkund në Rregullore kjo punë, as Kryetarja e Kuvendit nuk e thotë dot këtë gjë, sepse jam unë ai që kam të drejtë ta bëj pyetjen. Kështu që, për këto tjetërsime, për këtë rrëmbim të Rregullores, për këtë marrje peng 6të parlamentit, që keni marrë përsipër të bëni, sigurisht që këtë përgjigje do të keni, sepse ne nuk mund të pranojmë që të na merrni peng; të barabartë po, por peng jo. Salla këtu nuk është as e mazhorancës dhe as e drejtuesit të seancës, por është e deputetëve, të cilët ndahen vetëm kur votojnë. Kë votojnë dhe kë nuk votojnë është në diskrecionin e tyre. Kjo seancë është nul, sepse ka filluar me mashtrim.

Më së fundi pamë që u provua se e gjithë kërkesa për t'i ikur interpelancës së pyetjeve dhe mocionit, është mashtrim. Seanca duhet të ndalet, të vijë Kryeministri dhe t'u japë përgjigje pyetjeve. Këtë detyrim nuk e ka për qejfin e opozitës, por e ka si detyrim ndaj Rregullores. Në të kundërt, kur Rregullorja nuk vepron, atëherë do të veprojmë në këto mënyra për të vendosur prapë rendin.